



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 95

Prishtinë, më 19.11.2012, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina dhe Boban Todorović.

Mungoi : Daut Haradinaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 12.11.2012,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë për menaxhimin me Komplekset memorialë të Kosovës,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12.11.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 12.11.2012.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë për menaxhimin me Komplekset memorialë të Kosovës

Kryetari i Komisionit Nait Hasani përshëndeti të pranishmit dhe konstatoi se informatat e dërguara dhe propozimet nga MMPH nuk garantojnë se do të kompletohet në tërësi ky Projektligj duke potencuar disa çështje të rëndësishme p.sh. si duhet të bëhet kërkesa formale për një kompleks memorial dhe procedura deri në miratim, përkatësisht si shpallet një zonë e veçantë, gjithashtu pyeti për disa raste konkrete a janë paraparë ose pse nuk janë paraparë (masakra e Dubravës, Lubeniqi etj), ndërkaq **Salih Morina** insistoi se duhet të parashihen kriteret e caktuara. **Afërdita Berisha** ishte e mendimit që MMPH duhet të pyesin Komunitetet të cilat pastaj parashitrojnë kërkesën për një zonë të veçantë, kërkesë e cila pastaj e kompletuar vazhdon në Qeveri me arsyetimin e zgjeruar. **Nait Hasani** sugjeroi për një angazhim të MMPH në ditët në vijim, e cila do të kërkon nga Komunitetet planet e tyre në këtë drejtim, dhe pas përgjigjeve do të dihen pjesët e këtyre zonave, me çka do të krijohen kushtet për të përfunduar këtë Ligj të rëndësishëm. **Adnan Elshani** nga MMPH sqaroi se ministria në vazhdim do të angazhohet në bazë të Nenit 12 të Ligjit për Planifikim Hapësinor dhe Udhëzimeve administrative dhe do të kërkojë nga Komunitetet përgjigjet rreth pyetjeve të parashtruara në këtë Komision, ndërsa për Ligjin e “Kompleksit Adem Jasharit” poashtu ceku se duhet të potencohet në këtë Ligj a do të hyjë në kuadër të këtij Ligji apo do të mbetet si Ligj i veçantë. Përfaqësuesi i administratës së Kuvendit përkatësisht eprori përkatës sqaroi para Komisionit disa çështje kontestuese në këtë Projektligj duke cekur çështjen e Akteve nënligjore të cilat duhet të precizohet kush do ti nxjerr, a do të rishkruhet Projektligji nga MMPH apo nga Kuvendi etj. **Kryetari i Komisionit** përsëriti parimet bazë nga mbledhja e kaluar në bazë të cilave Komisioni nxori këtë :

P Ë R F U N D I M

Deri më 10 dhjetor 2012, MMPH të angazhohet rreth kërkesave dhe plotësimit të dilemave në këtë Komision.

Pas konsultimit me Komunitetet e Kosovës, MMPH të parashitroi propozimet konkrete rreth Projektligjit për Agjencinë për menaxhimin me Komplekse Memorialë, në bazë të cilave Komisioni do të angazhohet rreth amendamentimit të këtij Projektligji.

Mbledhja përfundoi në orën 12,10.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani**